REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

PROJEKT- VENDIM

Nr.128 Datë31.10.2025

"PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKISË SARANDË NR.72 DATË 23.12.2024"

Bazuar në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", nënpika 1.1, shkronja "a" "c", nenin 23, pika 11, nenin 54, nenin 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit" të ndryshuar; ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" të ndryshuar; ligjin nr. 20, datë 5.3.2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 500, datë 14.8.2001, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e vetëqeverisjes vendore" të ndryshuar; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 27.1.2023, "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve"; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 7.10.2020, "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtjen e hartës kadastrale"; udhëzimin nr. 15, datë 30.6.2003 të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimin "Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike", koorespodencës me Entin Kombëtar të Banesave, Këshilli Bashkiak pasi shqyrtoi relacionin të përgatitur nga Drejtoria Juridike , Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.72 datë 23.12.2024 "Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë të pronës me nr.pasurisë nr. pasurie 6/64, e llojit "truall", zk. 8642" , pika 1 të ndryshohet si më poshtë:
   " *Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë të pronës me nr.pasurisë 6/139, 6/121, 6/97,6/96,6/95,6/71,3/53, e llojit "truall" me sipërfaqe 14.542,9 m², zk. 8642, për t'iu përdorur në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, sipas formularit , gjithej 1 (një) dhe planin e rilevimit gjithsej 1 (një) bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi".*
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social, Drejtoria Juridike , dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Irena MARJANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SARANDË